

V.N.M. PARAPRAKE

MAGAZINË E DEPOZITIMIT TË MIELLIT.

SUBJEKTI "SKRAQI" SH.P.K.

ELBASAN

a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.

Projekti i paraqitur ka për qëllim të realizojë ndërtimin dhe vënien në përdorim të një godine një katëshe, me përmasa gjatësi 22.1 m, gjërësi 16.2 m dhe lartësi 10 m, deri në pjesën e tavanit ose fundi i kolonave dhe 12.21 m kulmi i çatisë. Godina do të shërbeje si vend për magazinimin e prodhimeve të Subjektit SKRAQI shpk. Kjo godinë do të ndërtohet mbi truallin e magazinës egzistuese. Dmth do të priset magazine egzistuese dhe do të ndërtohet një magazinë e re, duke i dhënë më shumë mundësi veprimtarisë së prodhimit të miellit për rritje të aftësisë depozituese në sasi dhe lloje.

Godina e ndërtuar do të jetë e lidhur në mënyrë funksionale me rrjetet inxhinjerie të këtij subjekti, duke qënë kështu në tërësi pjesë funksionale e tij.

Nga ky përshkrim është e kuptueshme që nuk kemi zhvillime të projektit në truall apo sipërfaqe toke të re, që shërben aktualisht për një qëllim të caktuar. Rrjedhimisht nuk ka tjetërsim trualli të ri, kështu që nuk dëmtohet mbulesa bimore që rrezikohen të prishen.

b) Informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.

Ndërtimi i objektit magazinë, për depozitimin e produkteve të fabrikës së miellit, zhvillohet plotësisht në territorin privat të këtij subjekti, mbi truallin ku aktualisht gjendet magazina egzistuese. Nuk ka burime uji në këtë truall dhe pranë tij.

c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Zbatimi i projektit për ndërtimin e magazinës së re, të depozitimit të produkteve të fabrikës së miellit, pritet të shoqërohet me zhvillime të mundshme me ndikim në mjedis. Vlerësojmë se zbatimi i projektit të paraqitur do të krijojë probleme mjedisore të ndara në këto faza kryesore :

- gjatë ndërtimit.
- pas ndërtimit.
- gjatë funksionimit.

Gjatë dhe pas fazës që përfshin ndërtimin, do të ketë kryesisht shkarkime të pluhurave dhe zhrumave si dhe të gazeve që dalin nga mjetet e ngarkimit e të transportit.

Vënia në shfrytëzim e kësaj magazine depozitimi miellrash, nuk shoqërohet me zhvillime procesesh të cilët gjenerojnë shkarkime me ndikim në treguesit cilësor të mjedisit.

ç) *Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;*

i. *Ndikime nga shkarkimet në ajër.*

Proçeset që zhvillohen gjatë fazës së prishjes së objektit egzistues dhe ndërtimit të objektit të ri, do të shoqërohen me shkarkime në ajër të grimcave të ngurta/pluhuri (PM10 dhe PM2.5), të gazeve përbërës të produkteve të djegies së karburanteve (gaz karbonik CO₂, gaz sulfuror SO₂, okside të azotit NO_x, etj.

Shkarkimet e gazta dhe të ngurta do të vijojnë aq kohë sa zgjatin proçeset më me influencë në këto shkarkime, të cilat po i listojmë në vijim:

- punimet për prishjen e ndërtesës
- punimet e gërmimit ;
- ngarkimi/shkarkimi i dherave, inerteve, çimentos dhe materialeve të tjerë ndërtimorë.

ii. *Ndikime nga shkarkimet në tokë.*

Trualli ku do të ndërtohet godina duke përfshirë edhe një sipërfaqe prej rreth 15% rrotull tij, do të ndikohet në cilësinë e tij :

- Nga punimet për prishjen e ndërtesës egzistuese, punimet e gërmimit, transportit dhe depozitimit të dherave, inerteve, çimentos dhe materialeve të tjerë ndërtimorë.
- Nga derdhjet e mundëshme të vajrave lubrifikantë dhe karburanteve nga mjetet e gërmimit, të transportit etj.
- Nga derdhjet e pakontrolluara të bojrave e tretësve të tyre.

iii. *Ndikime nga shkarkimet në ujë.*

Ujrat sipërfaqësorë mund të ndoten nga mbartja e grimcave të ngurta të dherave, inerteve, çimentos dhe materialeve të tjerë ndërtimorë.

iv. *Ndikime nga zhurmat dhe vibrimet.*

Zhurmat dhe vibrimet do të jenë të pranishme gjatë fazës së ndërtimit, në kohën që punojnë mjetet e gërmimit, të ngarkimit dhe ato të transportit. Zhurma do të shkaktojnë edhe betonjerat dhe vibratorët.

v. ***Ndikime në pejsazh.***

Trualli nuk do të ketë ndryshime të dukëshme topografike sepse kemi të bëjmë me një truall përgjithësisht të sheshtë. Nuk do të bëhet ndërhyrje për nivelimin e sheshit të ndërtimit.

Në pejsazhin e brendëshëm të subjektit dhe në atë jashtë tij, do të përfshihet edhe një godinë një katëshe, e cila do të jetë e harmonizuar me kompleksin ndërtimor të këtij subjekti.

vi. ***Gjenerimi i mbetjeve të ngurta.***

Mbetjet e ngurta që gjenerojnë gjatë zhvillimit të proceseve ndërtimore, përshkruhen në vijim:

- Inertete që dalin gjatë prishjes së ndërtesës egzistuese.
- Dherat e nxjerrë gjatë gjurmimeve.
- Inertet dhe mbetjet e material të ndërtimit.
- Ambalazhe të drurit, plastikës, qelqit, letrës/kartonit etj.

Në V.K.M. Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, bëhet ky klasifik për këto lloje mbetjesh.

17 MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA)

- 17 01 Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika
- 17 02 Dru, qelqe dhe plastika
- 17 03 Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të zifit
- 17 04 Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve)
- 17 05 Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)
- 17 06 Materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest
- 17 08 Materiale ndërtimi me gips
- 17 09 Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve

d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar.

Nga analiza e projektit teknik të hartuar për ndërtimin e kësaj magazine, vlerësohet se punimet ndërtimore mund të përfundojnë brenda tre muajve kalendarikë, nga momenti i fillimit të punimeve për prishjen e magazinës egzistuese deri në përfundimin e punimeve për ndërtimin e magazinës së re. Kjo është edhe periudha maksimale e mundëshme gjatë së cilës do të identifikohen ndikime negative në mjedis të përshkruara në kapitujt paraardhës.

dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Duke vlerësuar në tërësi përmbajtjen teknike të projektit që do zbatohet, periudhën relativisht të shkurtër (jo më shumë se tre muaj) të zhvillimit të operacioneve të punës që do mund të shkaktojnë ndikime negative në mjedis, përkohshmërinë e të gjithë ndikimeve të përshkruara (asnjë element nuk është mbetës apo që muind të konservohet si ndotës) si dhe pozicionin gjeografik të objektit në raport me objekte të cilat mund të ndikohen, nuk pritet që ndikimet e përshkruara të kenë shtrirje hapësinore.

e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Besojmë se e kemi qartësuar në shpjegimet e mësipërme se, në përfundim të punimeve të ndërtimit të magazinës së re, do të kryejt një reabilitim i plotë i sipërfaqes së truallit, të ndikuar nga zhvillimi i punimeve të ndërtimit. Punimet e reabilitimit përfshijnë:

- Largimin e të gjitha llojeve të mbetjeve të gjeneruar gjatë punimeve të ndërtimit;
- Sistemimin e truallit, duke kryer punimeve të nivelimit nëpërmjet mbushjes së gropave etj.
- Shtrimin me asfaltobeton të rrugës lidhëse të kësaj magazine me objektet e tjera të fabrikës;
- Krijimin e sipërfaqe të gjelbërta duke mbjellë bar e lule, si dhe pemë dekorative ose frutore duke i përshtatur ato me sipërfaqet egzistuese të gjelbërta.

Të gjitha këto lloje punimesh si dhe kostot përkatëse janë të përfshira në projektin e ndërtimit dhe të preventivit financiar të magazinës së re.

Magazine e re do të jetë pjesë funksionale e fabrikës së prodhimit të miellit dhe është një investim që parashikohet të jetë afat gjatë. Ky investim ka lidhje të drjetpëdrejtë me zhvillimet e kësaj fabrike kështu, që nuk mund të vlerësohet prishje e tij e veçantë nga ajo e fabrikës.

ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Është e rëndësishme të kuptohet dhe të zbatohet praktikisht, një marëdhënie bashkëpunimi mbi baza ligjore, ndërmjet investitorit, subjektit që do të kryej punimet e ndërtimit si dhe administratës së pushtetit vendor, mbi zbatimin e proceseve më të mira të mundshme të administrimit të mbetjeve të cilat do të gjenerojnë gjatë ndërtimit të objektit.

Legjislacioni mjedisor në fuqi, synon mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit, duke përcaktuar specifikime dhe kushte të normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit, të ujrave sipërfaqësore e nëntoksore, të cilësisë dhe vlerave të tokës, të territoreve urbane si zona të gjelbëruara, sheshe e rrugë publike.

Në V.K.M. Nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, përcaktohen detyrime konkrete të subjektit që kryen investimin, për mënyrën e administrimit të mbetjeve të krijuara gjatë proceseve të ndërtimit të objektit. Këtu përcaktohen edhe marrëdhëniet e subjektit me administratën e qeverisjes vendore, në rastin konkret Bashkisë Elbasan.

Në tabelën në vijim, pasqyrohen veprimet që duhet të kryhen me qëllim parandalimin, minimizimin apo eliminimin e ndotjeve që do të shkaktohen gjatë zhvillimit të proceseve të ndryshme ndërtimore.

Proçesi ndërtimor	Ndotja që shkaktohet	Periodha e gjenerimit.	Ndërhyrjet që duhen kryer.	Efektet e pritëshme	Personi përgjegjës
Prishja e ndërtesës, gërmime dhe transporti i dherave/inerteve.	Shkarkim i : a. Pluhurave b. Gazeve. c. Zhurmave.	Koha gjatë të cilës zhvillohet proçesi.	Rrethimi i të gjithë teritorit ku kryhen punimet. Lagja e dherave /inerteve që ngarkohen. Mbulimi i mjeteve që transportojnë këto dhera/inerte. Përdorim i mjeteve me kushte teknike normale. Larja e gomave të mjeteve të transportit sa herë që ato dalin nga kantjeri i ndërtimit. Përdorimi i karburanteve cilësore. Zhvillim i punimeve të ndërtimit si dhe i transportit të mbetjeve dhe materialeve ndërtimor, në orare të përcaktuara nga administrata vendore.	Parandalimi dhe zvogëlimi i: Sasisë së pluhurit të shkarkuar; Sasisë së gazeve të produkteve të djegies së karburanteve. Intesitetit të zhurmave të gjeneruara.	Drejtuesi i punimeve të subjektit që kryen punimet e ndërtimit. Drejtuesi ligjor i subjektit që kryen investimin.
Punimet e ndërtimit.	Shkarkim i : a. Pluhurave. b. Zhurmave. Krijimi i mbetjeve të ngurta, si betone, tulla, dërrasa, metal, letër etj.	Kaha gjatë së cilës kryhen punimet e ndërtimit.	Vendosja e rrjetave mbrojtëse në skela dhe vende ku kryhen proçeset e shkarkimit të inerteve, çimentos etj. Sistemimi i mbetjeve të krijuara në vende të caktuara, brenda teritorit të rrethuar të objektit që ndërtohet.	Parandalimi dhe zvogëlimi i: Sasisë së pluhurit të shkarkuar; Intesitetit të zhurmave të gjeneruara.	Drejtuesi i punimeve të subjektit që kryen punimet e ndërtimit. Drejtuesi ligjor i subjektit që kryen investimin.

EKSPERT I MARRËSI
 I LUFTËRA
 I SHËRBUJTI
 I ZHURMASH
 I LUFTËRA

Pastrimi dhe reabilitimi i truallit, pas përfundimit të punimeve të ndërtimit.

Shkarkim i : a. Pluhurave b. Gazeve. c. Zhurmave.	Koha gjatë së cilës kryhen punimet e pastrimit nga mbetjet, shtrimit të trutave rreth godinës, krijim apo reabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta etj	Evadimi në kohë të përshtatëshme dhe me mjete të mbuluara i këtyre mbetjeve për në vendin e përcaktuar nga Bashkia.	Ndotjen e tokës nga mbetjet e krijuara.	Drejtuesi i punimeve të subjektit që kryen punimet e ndërtimit.
		Mbajtja e rrjetave mbrojtëse në vende ku kryhen proceset e çvendosjes dhe të ngarkimit të dherave /inerteve, mbetjeve etj.	Parandalimi dhe zvogëlimi i:	
		Sistemimi i mbetjeve të krijuara në vende të caktuara, brenda teritorit të rrethuar të objektit që ndërtohet.	Sasisë së pluhurit të shkarkuar;	
		Evadimi në kohë të përshtatëshme dhe me mjete të mbuluara i këtyre mbetjeve për në vendin e përcaktuar nga Bashkia.	Intesitetit të zhurmave të gjeneruara.	Drejtuesi ligjor i subjektit që kryen investimin.
			Ndotjen e tokës nga mbetjet e krijuara.	

EKSPERTI I MEDISIT
 ENKELI BASHKIRI
 SH.82041
 LUBRASAN

f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Zbatimi i projektit të ndërtimit të magazinës së re të depozitimit të produkteve të fabrikës së mielli, nuk mund të shkaktojë ndikime në mjedisin ndërkufitar, jo vetëm për argumentat e përshkruar në kapitujt e mësipërm por edhe për faktin që vendi ku zhvillohet projekti nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë apo afërsi gjeografike me mjedise ndërkufitare.

LOERMA SH.P.K

ING. SHPRESA BANJA

E K S H P E R M J E D I S I
LOERMA
SH.P.K
L 0 2 9 2 8 2 0 4 T
ELBASAN